



FLETORJA ZYRTARE

E

REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare

Nr. 17	2000	Qershor
--------	------	---------

P Ë R M B A J T J A

Dekret nr.2643, Datë 8.6.2000	Për lënie të shtetësisë shqiptare	803
Vendim i KM Nr.278, datë 2.6.2000	Për krijimin e Institutit të Policisë Shkencore	804
Vendim i KM Nr.281, datë 2.6.2000	Për organizimin dhe funksionimin e Akademisë së Policisë	804
Vendim i KM nr.284, datë 2.6.2000	Për një ndryshim në vendimin e Këshillit të Ministrave, nr.393, datë 3.9.1992, "Për pagat e punonjësve të Institucioneve Buxhetore"	807
Vendim i KM Nr.285, datë 2.6.2000	Për një ndryshim në vendimin nr.544, datë 14.11.1994, të Këshillit të Ministrave "Për përballimin e shpenzimeve për birësimet"	807
Vendim i KM Nr.286, datë 2.6.2000	Për kriteret e blerjes dhe shitjes së apartamenteve nga Enti Kombëtar i Banesave në tregun e lirë të banesave	808

Vendim i KM Nr.287, datë 2.6.2000	Për një ndryshim në vendimin e Këshillit të Ministrave nr.250, datë 16.4.1996, për procedurat dhe prioritetet në zbatim të ligjit nr.8030, datë 15.11.1996, për kontributin e shtetit për familjet e pastreha	809
Vendim i KM Nr.291, datë 2.6.2000	Për një ndryshim në vendimin nr.475, datë 14.10.1999, të Këshillit të Ministrave, "Për një ndryshim në vendimin e Këshillit të Ministrave nr.473, datë 29.9.1993, "Për të drejtat e punonjësve të përfaqësive diplomatike të Republikës së Shqipërisë në shtetet e huaja dhe për shpenzimet e udhëtimit dhe të dietës për personat që dalin jashtë shtetit"	810
Vendim i KM Nr.292, datë 2.6.2000	Për shpronësimin e godinës aktuale të muzeut etnografik në qytetin e Krujës për interesa publike	811
Vendim i KM Nr.294, datë 13.6.2000	Për miratimin e planit të përdorimit të tokës në Portin e Durrësit	813
Vendim i KM Nr.295, datë 13.6.2000	Për privatizimin e hoteleve të ndërmarrjes "Albturist", Tiranë	813
Vendim i KM Nr.306, datë 13.6.2000	Për disiplinën në shërbimin civil	814
Vendim i KM Nr.307, datë 13.6.2000	Për privatizimin me tender të ndërmarrjeve hotel "Dajti", Tiranë dhe hotel "Skampa", Elbasan	816
Vendim i KM Nr.309, datë 13.6.2000	Për tarifat e përdoruesve të pronësisë artistike	817
Vendim i Gj.K	Me objekt: Papajtueshmëria me Kushtetutën e nenit 473 të Kodit të Procedurës Civile në paragrafin e dytë shprehja, "Nuk mund të marrin pjesë gjyqtarët që kanë drejtuar çështjen" dhe në paragrafin e katërt shprehja, që nuk kanë marrë pjesë në gjykimin e çështjes"	819
Vendim i Gj.L	Me objekt: Pjestim pasurie, marrjen e masës së sigurimit duke pezulluar punimet që i padituri bën në oborrin e shtëpisë. Neni 200 e vijues i Kodit Civil dhe 153, 202, e 369/a të K.Pr.Civile	822

D E K R E T
Nr.2643, datë 08.06.2000

PËR LËNIE TË SHTETËSISË SHQIPTARE

Në mbështetje të nenit 92, pika “c”, të Kushtetutës, të neneve 15, 19 dhe 20 të ligjit nr.8389, datë 05.08.1998 “Për shtetësinë shqiptare”, bazuar edhe në propozimin e Ministrit të Rendit Publik,

D E K R E T O J:

Neni 1

U hiqet shtetësia shqiptare me kërkesë të tyre personave të mëposhtëm:

1. Ilirjan Niko Xibinaku
2. Kera Ilirjan Xibinaku
3. Piters Ilirjan Xibinaku
4. Andoneta Bido Xibinaku (Duro)
5. Saimir Ali Vraja
6. Ene Faik Aliko
7. Saimir Besnik Sheremeti
8. Artur Lelo Lelaj
9. Elida Imer Görlich (Manaj)
10. Oriana Stavri Dost (Ruvina)
11. Rozeta Shahin Brix (Bardhi)
12. Fatbardh Ferit Markja
13. Elisa Fatbardh Markja
14. Gabriela Fatbardh Markja
15. Nadire Shefqet Markja (Buzi)
16. Eris Viktor Kerner (Topulli)
17. Nexhmije Qamil Paul (Kajmeni)
18. Vita Zef Rrozhani (Kümmerling)
19. Adriana Mete Hörmann (Zholi)
20. Dolores Ernesto Ohm (Kraja)
21. Belinda Urim Kraja

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë.

PRESIDENTI I REPUBLIKËS
Rexhep Meidani

V E N D I M
Nr.278, datë 2.6.2000

PËR KRIJIMIN E INSTITUTIT TË POLICISË SHKENCORE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të ligjit nr.8533, datë 25.11.1999, “Për Policinë e Shtetit” dhe të ligjit nr.7893, datë 2.12.1994, “Për Shkencën dhe Zhvillimin e Teknologjisë”, me propozimin e ministrit të Rendit Publik, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Në Ministrinë e Rendit Publik mbi bazën e Laboratorit Qendror të Kriminalistikës, krijohet Instituti i Policisë Shkencore. Ai varet nga Drejtori i Përgjithshëm i Policisë së Shtetit.

2. Objekt i punës së Policisë Shkencore është:

- Organizimi dhe drejtimi i veprimtarisë së Policisë Shkencore në të gjithë drejtoritë dhe komisaritet e policisë.

- Kryerja e ekspertimeve kriminalistike dhe kqyrja e vendit të ngjarjes për veprat penale të ndodhura.

- Puna kërkimore shkencore në aplikimin e metodave të reja shkencore në fushën e kriminalistikës.

- Përgatitja e kualifikimi i specialistëve të policisë shkencore.

3. Instituti i Policisë Shkencore kryen veprime edhe me kërkesën e organeve të drejtësisë, institucioneve të ndryshme, si dhe për personat juridikë e fizikë, kundrejt pagesës sipas tarifave të përcaktuara me akte të veçanta.

4. Të ardhurat e krijuara nga kryerja e ekspertimeve kriminalistike ndaj të tretëve do të administrohen nga Instituti i Policisë Shkencore, sipas kriterëve të përcaktuara në vendimin nr.424, datë 9.7.1998, të Këshillit të Ministrave, “Për krijimin dhe administrimin e të ardhurave që krijojnë institucionet buxhetore”.

5. Struktura dhe organika e Institutit të Policisë Shkencore përcaktohen nga ministri i Rendit Publik, ndërsa efektet financiare që do të shërbejnë për veprimtarinë dhe funksionimin e këtij instituti të përballohen nga buxheti i Ministrisë së Rendit Publik për vitin 2000.

6. Ngarkohet Ministria e Rendit Publik të marrë masa për zbatimin e këtij vendimi dhe nxjerrjen e akteve përkatëse që do të rregullojnë veprimtarinë e këtij Instituti.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare

KRYEMINISTRI
Ilir Meta

V E N D I M
Nr.281, datë 2.6.2000

PËR ORGANIZIMIN DHE FUNKSIONIMIN E AKADEMISË SË POLICISË

Në mbështetje të nenit 100, të Kushtetutës dhe në zbatim të nenit 29, të ligjit nr.8461, datë 25.2.1999, “Për Arsimin e Lartë në Republikën e Shqipërisë”, dhe të ligjit nr.8553, datë 25.11.1999 “Për Policinë e Shtetit”, me propozimin e ministrit të Rendit Publik, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Akademia e Policisë është shkollë e lartë dhe institucioni i vetëm përgjegjës për realizimin e arsimit policor të punonjësve të Policisë së Shtetit.

2. Akademia e Policisë ka për mision formimin dhe kualifikimin e punonjësve të policisë të të gjitha niveleve për të qënë të aftë e të përkushtuar për mbrojtjen e rendit dhe sigurisë publike.

3. Akademia e Policisë është person juridik dhe përfaqësohet nga drejtori.
4. Akademia e Policisë ka për detyrë:
 - Të realizojë formimin profesional të punonjësve të policisë të rolit të mesëm;
 - Të kryejë kurse kualifikimi e specializimi për punonjësit e policisë të rolit të mesëm, të lartë e madhor;
 - Të realizojë kualifikimin shkencor pasuniversitar sipas kritereve të përcaktuara.
5. Kohëzgjatja e studimeve të formimit bazë profesional të punonjësve të policisë të rolit të mesëm është tre vite akademike me shkëputje nga puna.

Për shtetasit që vijnë me arsim të lartë jopolicor afati i studimit është deri në një vit akademik.

Kualifikimi i punonjësve të policisë të rolit të mesëm, të lartë e madhor bëhet me afate kohore, sipas llojit të kualifikimit, nevojave, në mënyrë periodike dhe në bazë të kritereve të përcaktuara në aktet ligjore e nënligjore për gradat në policinë e shtetit.

Akademia e Policisë bën edhe kualifikimin e punonjësve të policive të tjera, në bazë të marrëveshjes paraprake ndërmjet Ministrisë së Rendit Publik dhe ministrive nga të cilat ata varen.
6. Në varësi të Akademisë së Policisë krijohet Instituti i Policisë, i cili ka për detyrë formimin profesional të punonjësve të policisë në rolin bazë, në një afat kohor një vit akademik. Kjo detyrë arrihet mbi bazën e realizimit të planeve e programeve nga strukturat përgjegjëse të këtij Instituti.

Në përbërje të institutit të policisë janë edhe qendrat e kualifikimit të punonjësve të policisë në rolin bazë. Kualifikimi në këto qendra realizohet në një afat kohor nga dy deri në tetë javë.
7. Organizimi, drejtimi dhe kontrolli i procesit mësimor përcaktohen në statutin e kësaj shkolle. Struktura e Akademisë së Policisë dhe Statuti i saj miratohen nga ministri me propozim të Këshillit të Akademisë së Policisë.
8. Emërimi i drejtorit të Akademisë së Policisë bëhet në përputhje me nenet 8 dhe 20 të ligjit, “Për Arsimin e Lartë në Republikën e Shqipërisë”, dhe përzgjidhet ndër funksionarët me gradë të rolit madhor.
9. Emërimi dhe klasifikimi i personelit të Akademisë bëhet në përputhje me nenin 8 dhe 26 të ligjit, “Për Arsimin e Lartë në Republikën e Shqipërisë” dhe nenit 15 të ligjit, “Për Policinë e Shtetit”. Ndërsa për Institutin e Policisë bëhet sipas nenit 15 dhe 19 të ligjit, “Për Policinë e Shtetit”. Për personelin civil, klasifikimi bëhet sipas akteve ligjore në fuqi.
10. Akademia e Policisë për realizimin e misionit të saj, vendos marrëdhënie me shkollat e tjera të larta të vendit tonë për shkëmbim përvoja e bashkëpunimi në procesin mësimor, shkencor dhe në kualifikimin e personelit mësimdhënës. Me shkollat simotra të huaja zbatohet paragrafi 3 i nenit 8 të ligjit, “Për Arsimin e Lartë në Republikën e Shqipërisë”.
11. Pranimi në Akademinë e Policisë dhe në Institutin e Policisë bëhet me konkurs. Mënyra e organizimit të konkursit të pranimit dhe vlerësimit të rezultateve përcaktohen në rregullore të veçantë, të propozuar nga Këshilli i Akademisë së Policisë dhe të miratuar nga ministri.
12. Kuotat e pranimit në Akademinë e Policisë përcaktohen sipas nenit 31, paragrafi i dytë i ligjit, “Për Arsimin e Lartë në Republikën e Shqipërisë”, ndërsa në Institutin e Policisë, sipas urdhrit të ministrit.
13. Për t’u pranuar në Akademinë e Policisë dhe Institutin e Policisë konkurojnë shtetasit që plotësojnë kërkesat e nenit 16 të ligjit, “Për Policinë e Shtetit”, si dhe kërkesat e Rregullores së Personelit të Policisë së Shtetit.
14. Për t’u pranuar në Akademinë e Policisë, konkurojnë punonjës policë që kanë mbaruar Institutin e Policisë, mbasi të kenë punuar dy vjet në bazë. Raporti i pranimit ndërmjet kandidatëve jashtë rradhëve të policisë dhe atyre që kanë mbaruar Institutin e Policisë caktohet me urdhër të ministrit.
15. Trajtimi ekonomiko-financiar i studentëve të Akademisë së Policisë dhe kursantëve të Institutit të Policisë, bëhet sipas akteve normative të veçanta.
16. Studentët dhe kursantët pas pranimit në Akademinë dhe Institutin e Policisë, bëjnë betimin dhe nënshkruajnë kontratën e pranimit sipas nenit 17 të ligjit, “Për Policinë e Shtetit” dhe Rregullores së Personelit të Policisë së Shtetit.
17. Buxheti i Akademisë së Policisë është zë më vete në buxhetin e ministrisë. Në të përfshihen shpenzimet për Akademinë, kërkimet shkencore, botimet, Institutin e Policisë dhe kualifikimin e punonjësve të policisë të të gjitha niveleve.
18. Studenti që mbaron Akademinë e Policisë titullohet “specialist i lartë policie” dhe pajiset

me diplomë nga ky institucion.

Kursanti që mbaron Institutin e Policisë titullohet “polic” dhe pajiset me dëshmi, e cila lëshohet nga drejtoria e Akademisë së Policisë.

16. Në zbatim të nenit 43 të ligjit, “Për Arsimin e Lartë në Republikën e Shqipërisë”, dhe nenit 18, pika 3 të ligjit, “Për Policinë e Shtetit”, Akademia e Policisë bën njëvlerfshmërinë e certifikatave, diplomave dhe gradave shkencore të fituara në shkollat e huaja, në fushën e policisë, në përputhje me vendimin përkatës të Këshillit të Ministrave.

17. Ministri i Rendit Publik në zbatim të këtij vendimi, ngarkohet për të nxjerrë aktet nënligjore për funksionimin e Akademisë dhe realizimin e misionit të saj.

18. Vendimi nr.405, datë 15.9.1992 i Këshillit të Ministrave, “Për krijimin e Akademisë së Rendit Publik” dhe vendimi nr.437, datë 12.9.1994, i Këshillit të Ministrave, “Për disa ndryshime e shtesa në vendimin nr.405, datë 15.9.1992, të Këshillit të Ministrave”, si dhe aktet e tjera nënligjore që bien në kundërshtim me dispozitat e këtij vendimi shfuqizohen.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Ilir Meta

V E N D I M
Nr.284, datë 2.6.2000

PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN E KËSHILLIT TË MINISTRAVE NR.393, DATË 3.9.1992, “PËR PAGAT E PUNONJËSVE TË INSTITUCIONEVE BUXHETORE”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 6, të ligjit nr.8487, datë 13.5.1999, “Për kompetencat për caktimin e pagave të punës”, me propozimin e ministrit të Shtetit pranë Kryeministrit dhe ministrit të Shëndetësisë, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

Në vendimin e Këshillit të Ministrave nr.393, datë 3.9.1992, bëhen këto ndryshime:

1. Në lidhjen nr.1, “Renditja e funksioneve sipas klasifikimit”:

- në germën A5, shtohet emërtimi “Kryetar i Akademisë së Shkencave” dhe

- në germën A12, shtohen emërtimet “Zëvendëskryetar i Akademisë së Shkencave” dhe “Sekretar shkencor i Akademisë së Shkencave”.

2. Në lidhjen II-8, “Niveli i pagave për punonjësit e Akademisë së Shkencave”, përkatësisht pikat 1 e 2 ndryshojnë si vijon:

- Kryetar A 5

- Zëvendëskryetar, sekretar shkencor A12

3. Efektet financiare të këtij vendimi përballohen nga buxheti i Akademisë së Shkencave.

4. Në lidhjen II/A, pika 2, “shtesa të tjera”, pas shkronjës “c”, shtohet shkronja “c/1”, me këtë përmbajtje:

“Punonjësve, të cilët punojnë me të sëmuret psiqikë e me të meta mendore, u jepet shtesë në masën 15-20 për qind mbi pagën bazë mujore, sipas përcaktimit që do të bëjë ministri i Shëndetësisë.”.

5. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, përballohen nga buxheti i vitit 2000, i miratuar për Ministrinë e Shëndetësisë.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Ilir Meta

V E N D I M
Nr.285, datë 2.6.2000

**PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR.544, DATË 14.11.1994, TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE “PËR PËRBALLIMIN E SHPENZIMEVE PËR BIRËSIMET”**

Në mbështetje të nenit 100, të Kushtetutës, të nenit 3, të ligjit nr.7650, datë 17.12.1992, “Për birësimet e të miturve nga shtetas të huaj dhe për disa ndryshime në Kodin e familjes”, me propozimin e zëvendëskryeministrit dhe ministrit të Punës dhe Çështjeve Sociale, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

Fjala e parë e pikës 5 të vendimit, nr.544, datë 14.11.1994, të Këshillit të Ministrave ndryshohet si vijon:

“Anëtarët e Komitetit Shqiptar të Birësimeve kur marrin pjesë në mbledhje marrin një shpërblim mbi pagë, deri në 5 000 (pesëmijë) lekë në muaj”.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Ilir Meta

V E N D I M
Nr.286, datë 2.6.2000

**PËR KRITERET E BLERJES DHE SHITJES SË APARTAMENTEVE NGA ENTI
KOMBËTAR I BANESAVE NË TREGUN E LIRË TË BANESAVE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 4 e 13 të ligjit nr.8030, datë 15.11.1995, “Për kontributin e shtetit për familjet e pastreha”, me propozimin e ministrit të Punëve Publike, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Ministria e Punëve Publike, bazuar në gjendjen e tregut të lirë të banesave dhe ku vlera e apartamenteve tip është më e vogël se sa kostoja e ndërtimit nga Enti Kombëtar i Banesave dhe mbi bazën e kërkesave për strehim të organeve të pushtetit vendor, planifikon fondet për blerje apartamentesh në tregun e lirë të banesave me qëllim të shitjes së tyre qytetarëve që kanë statusin e të pastrehit.

2. Enti Kombëtar i Banesave, mbi bazën e fondeve të planifikuara i vë në dispozicion familjes së pastrehë fondin limit si më poshtë:

a) Për apartamentet 1+1 shumën prej 1.63 milionë lekësh

b) Për apartamentet 2+1 shumën prej 2.04 milionë lekësh

c) Për apartamentet 3+1 shumën prej 2.37 milionë lekësh

d) Këto shuma limit do të indeksohen me vlerën e koeficientit “k”, që përcaktohet për çdo vit me vendim të veçantë të Këshillit të Ministrave.

e) Fondi limit për çdo strukturë apartamenti do të ndryshojë çdo vit, duke reflektuar koston mesatare vjetore të ndërtimit në shkallë vendi.

3. Përdorimi i fondeve të mësipërme të bëhet nëpërmjet blerjeve nga tregu i lirë i banesave nga ana e vetë qytetarëve, mbështetur në listat nominale dhe strukturat e apartamenteve tip që përfitojnë, të hartuara nga organet e pushtetit vendor.

4. Enti Kombëtar i Banesave, bazuar në listat nominale, kryen veprimet financiare me pronarët shitës të banesave, vetëm pas paraqitjes dhe verifikimit të dokumentacionit ligjor përkatës, që vërtetojnë kryerjen e aktit të blerjes së banesave nga qytetarët, që e përfitojnë atë sipas këtij vendimi.

5. Qytetari që kërkon të shesë apartamentin e tij duhet të plotësojë dhe të paraqesë këto dokumente:

a) Kontratën e shitblerjes së apartamentit të noterizuar.

b) Vërtetimin e pronësisë të regjistruar në zyrën e regjistrimit të pasurive të paluajtshme në emër të qytetarit që kërkon të shesë apartamentin.

c) Vërtetim të lëshuar nga zyra e regjistrimit të pasurive të paluajtshme që apartamenti nuk është hipotekuar për efekt garancie bankare, apo të ndonjë pale të tretë për arsye të ndryshme.

Pranimi i dokumenteve të mësipërme do të bëhet nga degët e Entit Kombëtar të banesave në rrethe sipas afateve të përcaktuara në këtë vendim.

6. Qytetarët që përfitojnë sipas këtij vendimi, kur nuk kryejnë veprimet për blerjen e banesave brenda një afati 4-mujor nga momenti i vënies në dispozicion të fondeve përkatëse, u humbet e drejta për trajtim si të pastrehë.

7. Vendimi i Këshillit të Ministrave nr.160, datë 3.4.1995, "Për kriteret e blerjes dhe të shitjes së apartamenteve nga Enti Kombëtar i Banesave në tregun e lirë të banesave" dhe pika 7, paragrafi 2, ndarja e gjashtë e vendimit të Këshillit të Ministrave nr.321, datë 5.7.1999, "Për miratimin e shpërndarjes së fondeve, sipas rretheve, procedurat e miratimit të familjeve që përfitojnë dhe kushtet e dhënies së kredisë, në kuadrin e kredisë greke për strehimin" shfuqizohen.

8. Ngarkohen Ministria e Financave, Ministria e Punëve Publike, Enti Kombëtar i Banesave dhe organet e pushtetit vendor për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Ilir Meta

V E N D I M **Nr.287, datë 2.6.2000**

PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN E KËSHILLIT TË MINISTRAVE NR.250, DATË 16.4.1996, PËR PROCEDURAT DHE PRIORITETET NË ZBATIM TË LIGJIT NR.8030, DATË 15.11.1996, PËR KONTRIBUTIN E SHTETIT PËR FAMILJET E PASTREHA

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të ligjit nr.8030, datë 15.11.1995, "Për kontributin e shtetit për familjet e pastreha", neni 13, me propozimin e ministrit të Punëve Publike, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

Në vendimin e Këshillit të Ministrave nr.250, datë 16.4.1996, "Për procedurat dhe prioritetet në zbatim të ligjit nr.8030, datë 15.11.1995, "Për kontributin e shtetit për familjet e pastreha", pika 18 ndryshon si vijon:

- Ngarkohet Enti Kombëtar i Banesave, që në fund të çdo viti, t'i paraqesë për miratim Këshillit të Ministrave, vleftën mesatare vjetore të apartamenteve tip të tregut të lirë në shkallë rrethi. Këto të dhëna do të nxirren sipas shitblerjeve të apartamenteve tip të privatizuara, që bën Enti Kombëtar i Banesave në tregun e lirë të tyre. Vlefta mesatare vjetore do të paraqitet në lek/m² sipërfaqe banimi dhe do të përdoret në zbatim të ligjit për vitin pasardhës.

- Të dhënat do të nxirren sipas blerjeve që bën Enti Kombëtar i Banesave në tregun e lirë të banesave.

- Përcaktimi i vlerës reale të tregut të lirë të banesave do të bëhet në bazë të blerjeve të apartamenteve që bën Enti Kombëtar i Banesave në atë rreth.

- Vlera reale e një sipërfaqeje banimi është e barabartë me vlerën reale të apartamentit në raport me sipërfaqen e banimit. Ajo do të nxirret nga raporti i vlerës mesatare aritmetike të ofertave me sipërfaqen e çdo apartamenti. Në vlerën reale përfshihet edhe sipërfaqja e truallit ku ndodhet apartamenti.

Në ato qytete (bashki e komuna) ku gjatë një viti bëhen blerje, vlefte e tregut do të merret ajo e një viti më parë e miratuar nga Këshilli i Ministrave, ose do të përcaktohet në analogji me ato qytete që kanë afërsisht një vlerë tregu, duke e krahasuar atë, me atë të një viti më parë, por gjithmonë i miratuar nga Këshilli i Ministrave.

- Drejtoria Rajonale dhe degët e Entit Kombëtar të Banesave nëpër prefektura e qytete do të dërgojnë çdo fillim të muajit janar të vitit pasardhës në Drejtorinë e Përgjithshme të Entit Kombëtar të Banesave, formularin nr.1 bashkëlidhur.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Ilir Meta

FORMULARI NR.1

Treguesit kryesorë të banesës:

- Adresa e banesës
- Viti i ndërtimit
- Tipi i banesës dhe lloji i konstruksionit
- Sipërfaqja e banesës (banimit) dhe numri i ambienteve
- Vlefte totale
- Vlefte e llogaritur në lek/m2 sipërfaqe banimi

V E N D I M **Nr.291, datë 2.6.2000**

PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR.475, DATË 14.10.1999, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN E KËSHILLIT TË MINISTRAVE NR.473, DATË 29.9.1993, "PËR TË DREJTAT E PUNONJËSVE TË PËRFAQËSIVE DIPLOMATIKE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË NË SHTETET E HUAJA DHE PËR SHPENZIMET E UDHËTIMIT DHE TË DIETËS PËR PERSONAT QË DALIN JASHTË SHTETIT""

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 4 dhe të nenit 8, pika 2, shkronja "a", dhe pika 3, të ligjit nr.7870, datë 13.10.1994, "Për sigurimet shëndetësore në Republikën e Shqipërisë", me propozimin e ministrit të Punëve të Jashtme, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Vendimi nr.475, datë 14.10.1999, i Këshillit të Ministrave, ndryshohet si vijon:
"Ministria e Punëve të Jashtme për punonjësit e përfaqësive diplomatike të Republikës së Shqipërisë në shtetet e tjera dhe për bashkëshortët, si dhe fëmijët e tyre, të moshës parashkollore, nxënës dhe studentë me shkëputje nga puna, ka të drejtë të bëjë sigurimin shëndetësor si dhe sigurimet e tjera, të detyrueshme, të shtetit përkatës."

2. Punonjësit e përfaqësive tona jashtë shtetit, bashkëshortët, si dhe fëmijët e tyre, të moshës parashkollore, nxënës dhe studentë me shkëputje nga puna, kanë të drejtë që, për raste urgjencash, të mjekohen në vendin ku është përfaqësia, me miratimin e titullarit të përfaqësies, kur për një shërbim të tillë nuk është parashikuar siguri shëndetësor. Për raste të tjera shpenzimet përballohen nga vetë punonjësi i përfaqësies.

3. Efektet financiare të përballohen nga fondi i miratuar për Ministrinë e Punëve të Jashtme, në buxhetin e vitit 2000.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Ilir Meta

V E N D I M
Nr.292, datë 2.6.2000

**PËR SHPRONËSIMIN E GODINËS AKTUALE TË MUZEUT ETNOGRAFIK NË QYTETIN
E KRUJËS PËR INTERESA PUBLIKE**

Në mbështetje të nenit 100, të Kushtetutës dhe të nenit 2/d, e nenit 9 të ligjit nr.7848, datë 25.7.1994, "Për shpronësimet për interes publik, si dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë së paluajtshme", me propozimin e ministrit të Kulturës, Rinisë dhe Sporteve, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Shpronësimin për interes publik në favor të Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sporteve, të godinës aktuale të Muzeut Etnografik në qytetin e Krujës, në pronësi të z.Hamid Kalaja, z. Mexhit Kalaja, kundrejt kundravleftës në lekë të 74 466 USD për objektin dhe z. Gëzim Nova, z. Muharrem Tufa, Hamid Kalaja, Mexhit Kalaja kundrejt kundravleftës në lekë të 51 840 USD për truallin në mënyrën dhe masën e kompensimit të përcaktuar në listën bashkëlidhur të bashkëpronarëve.

2. Shpenzimet financiare sipas pikës 1, do të përballohen nga buxheti i Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sporteve.

3. Shpronësimi fillon me hyrjen në fuqi të vendimit dhe përfundon brenda datës 31.12.2001.

4. Ngarkohen për zbatimin e këtij vendimi Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sporteve dhe bashkia e qytetit Krujë.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Ilir Meta

**LISTA E PRONARËVE TË OBJEKTIT DHE TRUALLIT
TË MUZEUT ETNOGRAFIK, KRUJË**

Sipërfaqe banese

Sipërfaqja e përgjithshme.....611x150 USD/m2	= 91 650 USD
Amortizim..... 35%	= 32 077 USD
	59 573 USD
Vlera arkitektonike.....25%	= 14 893 USD
Vlera ndërtimore e shpronësimit	74 466 USD

Banesa (sip. e ndërtimit) ka dy pronarë:

1. Hamit Kalaja4.....80 m2 x 150 USD	= 72 000 USD
Amortizim..... -35%	= 25 800 USD
	46 800 USD
Vlerë arkitektonike+25%	= 11 700 USD
Vlera ndërtimore e shpronësimit	58 500 USD
2. Mexhit Kalaja.....131 m2 x 150 USD	= 19 650 USD
Amortizim..... -35%	= 6 877 USD
	12 773 USD

Vlerë arkitektonike.....+25%	= 3 193 USD
Vlera ndërtimore e shpronësimit	15 966 USD

Sipërfaqe trualli:

1. Gëzim Nova.....347 m2 x 60 USD	= 20 820 USD
2. Hamid Kalaja..... 335 m2 x 60 USD	= 20 100 USD
3. Muharrem Tufa..... 36 m2 x 60 USD	= 2 160 USD
4. Mexhit Kalaja..... 146 m2 x 60 USD	= 8 760 USD

Shuma	= 51 840 USD
-------------	---------------------

Shuma gjithsej për sipërfaqe ndërtimi	74 466 USD
---------------------------------------	-------------------

Shuma gjithsej për sipërfaqe trualli	+51 840 USD
--------------------------------------	--------------------

Shuma e përgjithshme	126 306 USD
-----------------------------	--------------------

V E N D I M
Nr.294, datë 13.6.2000

PËR MIRATIMIN E PLANIT TË PËRDORIMIT TË TOKËS NË PORTIN E DURRËSIT

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të ligjit nr.8383, datë 29.7.1998, “Për ratifikimin e marrëveshjes për kredinë e zhvillimit, ndërmjet qeverisë së Republikës së Shqipërisë dhe Shoqatës Ndërkombëtare të Zhvillimit (IDA), për projektin e Portit të Durrësit”, me propozimin e ministrit të Transportit, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Miratimin e planit të përdorimit të tokës në Portin e Durrësit dhe rekomandimet e tij, me skenarin 2, për fazën I, dhe objektiv përfundimtar skenarin 3, për fazën III.

2. Ngarkohet Ministria e Transportit së bashku me Ministrinë e Ekonomisë Publike dhe Privatizimit, Ministrinë e Bujqësisë dhe Ushqimit, Ministrinë e Punëve Publike, Ministrinë e Pushtetit Lokal, Ministrinë e Financave, Ministrinë e Mbrojtjes, Ministrinë e Rendit Publik dhe Ministrinë e Drejtësisë të negociojnë për përcaktimin e afateve të zbatimit të planit.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Ilir Meta

V E N D I M
Nr.295, datë 13.6.2000

PËR PRIVATIZIMIN E HOTELEVE TË NDËRMARRJES “ALBTURIST”, TIRANË

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 23, të ligjit nr.7512, datë 10.8.1991, “Për sanksionimin dhe mbrojtjen e pronës private, nismës së lirë, veprimtarive private, të pavarura, dhe privatizimit”, me propozimin e ministrit të Ekonomisë Publike dhe Privatizimit, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Për privatizimin e hoteleve të ndërmarrjes “Albturist” do të zbatohen kriteret dhe procedurat e vendimit nr.192, datë 20.3.1998, të Këshillit të Ministrave, “Për kriteret e vlerësimit të pronës shtetërore që privatizohet dhe procedurat e shitjes”, me ndryshimet dhe shtesat e mëposhtme:

- a) Në pikën 10 të kapitullit III, dy paragrafet e fundit ndryshojnë si vijon:
“- Të shpallë personin e fundit, që deklaron çmimin më të lartë.
- Të sigurojë që dhënia e ofertave të vazhdojë derisa të ketë oferta të tjera, përpara shpalljes së personit të fundit që deklaron çmimin më të lartë.”.
- b) Në pikën 11 të kapitullit III, pas paragrafit të parë shtohen paragrafet:
“- Agjencia Kombëtare e Privatizimit, brenda tri ditëve nga përfundimi i ankandit, përgatit projektvendimin dhe relacionin përkatës, së bashku me një kopje të dokumentacionit të plotë të ankandit, dhe ia paraqet për shqyrtim dhe miratim Këshillit të Ministrave.
- Vetëm, pasi Këshilli i Ministrave, miraton procedurën e ankandit dhe vendos privatizimin, sipas çmimit më të lartë, të arritur në ankand, Agjencia Kombëtare e Privatizimit vazhdon procedurat e mëtejshme, duke filluar nga pika 12 e kapitullit III, “Për kriteret e vlerësimit të pronës shtetërore që privatizohet dhe procedurat e shitjes”.
- Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Ilir Meta

V E N D I M
Nr.306, datë 13.6.2000

PËR DISIPLINËN NË SHËRBIMIN CIVIL

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 19, 25 dhe 29, të ligjit nr.8549, datë 11.11.1999, “Për statusin e nëpunësit civil”, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Janë shkelje disiplinore:
- a) Mosrespektimi i përsëritur i kohës dhe i orarit të punës.
b) Moskryerja e detyrave, apo mosrespektimi i përsëritur i afateve të caktuara për kryerjen e detyrave.
c) Shjellja e parregullt, gjatë kohës së punës, me eprorët, me kolegët, me varësit dhe me publikun.
ç) Dëmtimi i pronës shtetërore, përdorimi i saj jashtë përcaktimit zyrtar, krijimi pa shkaqe të pranueshme i mundësisë për dëmtim apo keqpërdorimi i pronës shtetërore.
d) Kryerja, brenda apo jashtë kohës së punës, të veprimeve, që ulin ose çenojnë figurën e nëpunësit civil, institucionin apo shërbimin civil në tërësi.
dh) Kryerja e punëve apo veprimtarive, të cilat çenojnë interesat e detyrës zyrtare ose që pengojnë përmbushjen e saj.
e) Shkelja e rregullave të etikës së shërbimit civil.
ë) Moszbatimi i dispozitave ligjore në përmbushjen e detyrave funksionale.
f) Shkelja e rregullave të përcaktuara për ruajtjen e sekretit shtetëror apo të mirëbesimit për të dhënat, të renditura si të tilla;
g) Shprehja e mendimeve apo kryerja e veprimtarive publike me karakter partiak në rolin e nëpunësit civil ose gjatë orarit të punës.
gj) Mosrespektimi i detyrave të tjera, të parashikuara në nenin 19, të ligjit nr.8549, datë 11.11.1999, “Për statusin e nëpunësit civil”.
2. Ecuria disiplinore fillon nga eprori i drejtpërdrejtë i nëpunësit civil, me vetveprimin e drejtpërdrejtë të eprorit ose me kërkesën drejtuar atij, nga çdo organ apo person i interesuar.
3. Kërkesa duhet të plotësojë këto kushte:
- a) Të jetë me shkrim;
b) Të identifikojë nëpunësin civil, i cili pretendohet se ka kryer shkeljen disiplinore;
c) Të përcaktojë veprimin konkret, që pretendohet se përbën shkelje disiplinore dhe rrethanat e

kryerjes së tij.

4. Kur eprori i drejtpërdrejtë vendos fillimin e ecurisë disiplinore njofton menjëherë, me shkrim, nëpunësin civil;

a) për të drejtën që ai ka, për të paraqitur me shkrim sqarimet e tij rreth shkeljes së pretenduar, afatin deri kur duhet të paraqitet ky sqarim;

b) për të drejtën që ai ka të dëgjohet, ai vetë apo me përfaqësues ligjor, dhe për të paraqitur dëshmitarë;

c) për datën kur do të shqyrtohet shkelja e pretenduar. Kjo datë nuk mund të caktohet, më vonë se 8 ditë, nga marrja e njoftimit.

5. Eprori i drejtpërdrejtë, nëse e çmon të arsyeshme, mund të ftojë, në ditën e caktuar për shqyrtimin e shkeljes, dëshmitarë, për të sjellë fakte rreth çështjes. Nëpunësi dhe përfaqësuesi i tij kanë të drejtë të jenë të pranishëm kur dëshmitarët sjellin fakte dhe t'i pyesin ata për faktet e sjella prej tyre.

6. Masa disiplinore quhet e përshtatshme, vetëm nëse është në përputhje me shkeljen disiplinore. Në përcaktimin e masave disiplinore merren parasysh shkaqet dhe rëndësia e shkeljes disiplinore, shkalla e fajësisë, rrethanat në të cilat është kryer shkelja, pasojat e shkeljes, rezultatet e vlerësimit individual, sjellja e përgjithshme në kryerjen e detyrave, si dhe nëse ka marrë masa disiplinore të mëparshme, të cilat nuk janë shlyer në kushtet e nenit 25, të ligjit nr.8549, datë 11.11.1999, "Për statusin e nëpunësit civil".

7. Pasi shqyrton çështjen, sipas rregullave të pikave 5 dhe 6 të këtij vendimi, dhe pasi dëgjon nëpunësin përkatës a përfaqësuesin ligjor apo vë në dukje me shkrim, mosparaqitjen e tij, megjithëse nëpunësi ka marrë dijeni kundrejt konfirmimit, eprori i drejtpërdrejtë vendos:

a) marrjen e një mase disiplinore, kur vëren se ka patur shkelje disiplinore.

b) ndërprerjen e ecurisë disiplinore, në rast kur vëren se:

- nuk ka shkelje disiplinore, siç ishte menduar;

- veprimi i shqyrtuar nuk përbën shkelje;

- veprimi nuk ka qenë ose nuk është kryer nga nëpunësi përkatës.

8. Vendimi i eprorit të drejtpërdrejtë për marrjen e masës disiplinore përmban këto të dhëna:

a) organin që ka marrë vendimin;

b) identifikimin e nëpunësit, ndaj të cilit është marrë masa;

c) masën e marrë;

ç) shkeljen faktike;

d) bazën ligjore;

dh) arsyetimin e vendimit dhe shpjegimin e fakteve, që janë bërë shkas për marrjen e vendimit;

e) datën e hyrjes në fuqi të vendimit, datë e cila nuk mund të jetë përpara datës së njoftimit të tij;

ë) të drejtën për t'u ankuar ndaj vendimit, afatin në të cilin mund të paraqitet ky ankim, si dhe organin përgjegjës për zgjidhjen e tij.

9. Një kopje e vendimit i dorëzohet nëpunësit, Departamentit të Administratës Publike për institucionet e administratës qendrore, departamentit, drejtorisë, seksionit, apo zyrës së personelit, për institucionet e pavarura, brenda 4 ditëve nga dhënia e tij.

10. Masa disiplinore, "vërejtje me paralajmërim", ka për qëllim këshillimin dhe paralajmërimin e nëpunësit për masa të tjera disiplinore, më të rënda, në rast përsëritjeje të shkeljes dhe nuk shënohet në dosjen vetjake të nëpunësit. Masat disiplinore të parashikuar në shkronjat "a", "c", "ç" dhe "d" të nenit 25, të ligjit nr.8549, datë 11.11.1999, "Për statusin e nëpunësit civil" shënohen në dosjen vetjake të nëpunësit, së bashku me një kopje të vendimit përkatës.

11. Mendimi i Departamentit të Administratës Publike, për institucionet e administratës qendrore, apo mendimi i departamentit, drejtorisë, seksionit e zyrës së personelit, për institucionet e pavarura, sipas pikës 2, të nenit 25 të ligjit nr.8549, datë 11.11.1999, "Për statusin e nëpunësit civil" është këshillomor dhe futet në dosjen vetjake të nëpunësit.

12. Ankimi në Komisionin e Shërbimit Civil paraqitet në formë shkresore dhe përmban këto të dhëna:

a) emrin dhe adresën e ankuesit;

b) vendimi që kundërshtohet (një kopje e tij);

- c) bazën ligjore dhe faktike të ankimit;
- ç) provat shkresore dhe çdo dokument tjetër, që vlerësohet i rëndësishëm nga ankuesi.

13. Pas shqyrtimit të ankesës, Komisioni i Shërbimit Civil vendos:

- a) rrëzimin e ankesës;
- b) shfuqizimin e vendimit të eprorit të drejtpërdrejtë;
- c) ndryshimin e masës disiplinore, në një masë më të lehtë apo më të rëndë;

14. Në rastin kur ndaj nëpunësit është marrë masa disiplinore e largimit nga shërbimi civil dhe komisioni vendos shfuqizimin apo ndryshimin e vendimit të eprorit të drejtpërdrejtë, nëpunësi merr pagën e plotë që nga çasti kur janë ndërprerë marrëdhëniet financiare.

15. Vendimi i Komisionit të Shërbimit Civil përmban të dhënat, të përcaktuara në pikën 8 të këtij vendimi.

16. Vendimi i Komisionit të Shërbimit Civil i njoftohet të interesuarit dhe institucionit nga sekretariati teknik, brenda 4 ditëve nga marrja e tij.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Ilir Meta

V E N D I M
Nr.307, datë 13.6.2000

**PËR PRIVATIZIMIN ME TENDER TË NDËRMARRJEVE HOTEL “DAJTI”, TIRANË DHE
HOTEL “SKAMPA”, ELBASAN**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 23, të ligjit nr.7512, datë 10.8.1991, “Për sanksionimin dhe mbrojtjen e pronës private, nismës së lirë, veprimtarive private dhe privatizimit” dhe të vendimit nr.408, datë 31.8.1999, të Këshillit të Ministrave, “Për privatizimin me tender të ndërmarrjeve shtetërore”, me propozimin e ministrit të Ekonomisë Publike dhe Privatizimit, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Tenderi i hapur do të jetë forma e privatizimit të ndërmarrjeve:

- a) Hotel “Dajti”, Tiranë
- b) Hotel “Skampa”, Elbasan

2. Procedura e tenderit të realizohet nga Agjencia Kombëtare e Privatizimit, sipas vendimit nr.408, datë 31.8.1999, të Këshillit të Ministrave, “Për privatizimin me tender të ndërmarrjeve shtetërore”

3. Vlerësimi i ndërmarrjeve të bëhet sipas vendimit nr.192, datë 20.3.1998, të Këshillit të Ministrave “Për kriteret e vlerësimit të pronës shtetërore që privatizohet dhe procedurat e shitjes” dhe trajtimi i detyrimeve, debitore dhe kreditore, të bëhet sipas kapitullit II, të po këtij vendimi.

4. Kriteret bazë të përzgjedhjes së ofertave do të jenë:

a) Pjesëmarrësi në tender të ketë përvojë të drejtpërdrejtë në fushën e hotelerisë dhe turizmit, me nivel cilësie jo më pak se tre vjet dhe jo më pak se pesë vjet.

b) Pjesëmarrësi në tender nuk do të ndryshojë qëllimin e objektit.

5. Pjesëmarrësi në tender, së bashku me ofertën e vet, duhet të paraqesë dokumentacionin që vërteton:

a) aktet e regjistrimit ose të barazvlefshmet me to, të çertifikuara jo më shumë se 60 ditë nga data e paraqitjes së tyre;

b) bilancin kontabël të audituar të tri viteve të fundit të veprimtarisë;

c) raportin e auditorëve të huaj ose vendas për tri vitet e fundit;

ç) një përshkrim të veprimtarive kryesore të tij në fushën e hotelerisë dhe të turizmit.

6. Kriteret bazë të vlerësimit të ofertave do të jenë:

- a) çmim i ofruar 60 pikë

- b) niveli dhe programi i investimit të propozuar 35 pikë
 - c) programi social për punësim 5 pikë
 - 7. Ngarkohen Ministria e Ekonomisë Publike dhe Privatizimit, Komiteti i Zhvillimit të Turizmit dhe Agjencia Kombëtare e Privatizimit për zbatimin e këtij vendimi.
- Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Ilir Meta

V E N D I M
Nr.309, datë 13.6.2000

PËR TARIFAT E PËRDORUESVE TË PRONËSISË ARTISTIKE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 7, të ligjit nr.8594, datë 4.2.2000, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.7564, datë 19.5.1992, “Për të drejtën e autorit”, të nenit 23, të ligjit nr.8410, datë 30.9.199, “Për radion dhe televizionin, publik dhe privat, në Republikën e Shqipërisë”, ne propozimin e ministrit të Kulturës, Rinisë dhe Sporteve, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Palët kontraktuese në kontratat me shoqëritë e autorëve, për përdorimin e pronësisë artistike, t’i përmbahen këtyre tarifave:
 - 1.1. Kanalet televizive publike: 2.5-3.5 milionë lekë të buxhetit të tyre.
 - 1.2. Radiot publike: 500 000 – 800 000 lekë buxhetit të tyre.
 - 1.3. Radiot lokale publike: 150 000-300 000 lekë të buxhetit të tyre.
 - 1.4. Televizionet lokale publike: 500 000-1 000 000 lekë të buxhetit të tyre.
 - 1.5. Kanalet televizive kombëtare, private: 1 000 000-2 000 000 lekë të buxhetit të tyre.
 - 1.6. Kanalet televizive rajonale private: 500 000-1 000 000 lekë të buxhetit të tyre.
 - 1.7. Radiot private kombëtare ose radiot private të huaja, që njehsohen me to, brenda territorit shqiptar: 400 000-700 000 lekë të buxhetit të tyre.
 - 1.8. Radiot private rajonale ose radiot e huaja, që njehsohen me to, brenda territorit shqiptar: 300 000-500 000 lekë të buxhetit të tyre.
2. Sallat, që nuk kanë qëlim kryesor shfaqjet muzikore, filmat, varietetë, spektaklet si: Pallati i Kongreseve, stadiumet, pallatet e sportit për lojëra me dorë, amfiteatre në mjedise të hapura etj, nënshkruajnë kontratë qiradhënieje me trupa të ndryshme, vetëm pasi qiradhënësi paraqet kontratën me shoqatat e autorëve: 4 për qind – 5 për qind të çmimit të biletave të shitura.
 - 2.1. Diskotekat, klubet e natës, pianobaret, restorante me pistë vallëzimi: vlera e çmimit mesatar të pijeve alkoolike për një ditë pune deri në 30 vende ulur. Për lokalet me mbi 30 vende ulur llogaritet në mënyrë proporcionale tarifa si më sipër.
 - 2.2. Për restorantet dhe kafenetë: vlera e çmimit të kafesë së konsumuar për një ditë pune, ndërsa për lokalet me mbi 30 vende ulur tarifa llogaritet në mënyrë proporcionale, si më sipër.
 - 2.3. Sallat e shfaqjeve kinematografike: 2 për qind – 2.5 për qind të arkëtimit të biletave të shitura.
 - 2.4. Teatrot dramatike, varietete, teatrot e operas, arenat e cirkut, teatrot e kukullave 1.5 për qind – 2 për qind të arkëtimit të biletave të shitura.
 - 2.5. Kur sallat e pikës 2.4 u jepen me qira subjekteve të tjera zbatohet detyrimi i pikës 2.
 - 2.6. Për trenat, anijet, tragetet, autobusët, avionët 0.1 për qind të çmimit të biletave të shitura, të llogaritura në monedhën që përdorin.
 - 2.7. Për hotelet, motelet, që përdorin muzikë në mjediset e tyre: kafene, pianobare, restorante me pistë vallëzimi, doskoteke, muzikë holle, zbatohen tarifat e përcaktuara në pikën 2.1.
 - 2.8. Hotelet dhe motelet, që kanë aparate televizive nëpër dhoma: 2 për qind-2.5 për qind të çmimit të dhomave për çdo ditë.
 - 2.9. Prodhuesit dhe shitësit e kasetave, vidiokasetave dhe kompaktdisqeve: 7.5 për qind – 9.5

për qind të çmimit të shitjes.

2.10. Subjektet që ushtrojnë veprimtarinë e dhënies me qera të kasetave, vidokasetave dhe kompaktdisqeve: 3.5 për qind – 4.5 për qind, të çmimit të qiradhënies për çdo kasetë.

3. Firmat e licensuara për vendosjen e internetit: 2.5 për qind – 3.5 për qind të shumës për çdo pajtimtar.

3.1. Sallat e aerobisë, të gjimnastikës artistike, palestrat e veglave të forcës, salla patinazhi artistik, kur përdorin muzikë: 1.5 për qind – 2 për qind të të ardhurave për çdo pajtimtar.

3.2. Lojërat e fatit si telebingot, bastet, sallat me lojërat e fatit: 1.5 për qind – 2 për qind të çmimit më të lartë fitues për çdo spektakël.

4. Ngarkohen ministri i Financave dhe ministri i Kulturës, Rinisë dhe Sporteve të nxjerrin një udhëzim të përbashkët për zbatimin e këtij vendimi.

5. Vendimi nr.342, dtë 3.7.1995, i Këshillit të Ministrave, “Për tarifat për përdoruesit e pronësisë artistike” shfuqizohet.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Ilir Meta

V E N D I M “NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË”

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Fehmi Abdiu,	Kryetar i Gjykatës Kushtetuese
Zija Vuci,	Anëtar i “““
Hajredin Fuga,	Anëtar i “““
Alfred Karamuço,	Anëtar i “““
Bardha Selenica,	Anëtar i “““
Kristofor Peçi,	Anëtar i “““
Kujtim Puto,	Anëtar i “““
Sokol Sadushi,	Anëtar i “““

me sekretare Arbenka Lalica, më datë 17.02.2000, mori në shqyrtim në seancë gjyqësore me dyer të hapura çështjen nr.10 Akti, që i përket:

KËRKUESE: GJYKATA E LARTË

SUBJEKTE TË INTERESUARA:

1. KUVENDI I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË, në mungesë
2. KËSHILLI I MINISTRAVE, në mungesë

O B J E K T I

Papajtueshmëria me Kushtetutën e nenit 473 të Kodit të Procedurës Civile në paragrafin e dytë shprehja, “nuk mund të marrin pjesë gjyqtarët që kanë gjykuar çështjen” dhe në paragrafin e katërt shprehja, “që nuk kanë marrë pjesë në gjykimin e çështjes”.

Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë, në çështjen civile me paditësa, Zyra Avdiu etj., dhe të paditur, Fatime Bodinaku e Banka e Kursimeve Tiranë, me objekt “Deklarimin e pavlefshëm të dëshmisë së trashëgimisë”, në seancë gjyqësore, duke iu referuar nenit 145/2 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, kanë vendosur pezullimin e gjykimit dhe dërgimin e çështjes Gjykatës Kushtetuese për t’u shprehur sipas objektivit të sipërcituar të kërkesës.

Kërkuesi në vendimin e tij të pezullimit të çështjes ka parashtruar disa argumenta lidhur me këtë çështje duke arsyetuar se:

- me interpretimin e dispozitës së sipërcituar konkludohet se nuk ndalohet pjesëmarrja në gjykimin e çështjes në Kolegjet e Bashkuara të Bashkuara të Gjyqtarëve edhe pse kanë marrë pjesë më

parë në gjykimin e çështjes në kolegji, por kufizohet pjesëmarrja e tyre në kolegjin seleksionues dhe qënia si relator në gjykimin në Kolegjet e Bashkuara;

- çënohet procesi i rregullt ligjor sipas nenit 42/1 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, sepse preket mënyra e formimit të trupit gjykues;

- neni 72 pika 4 e Kodit të Procedurës Civile që nuk lejon pjesëmarrjen e gjyqtarëve në një shkallë tjetër të procesit do të zbatohet edhe për gjyqtarët e Gjykatës së Lartë (ish Gjykata e Kasacionit) të cilët nuk duhet të marrin pjesë në gjykimin e çështjes në Kolegjet e Bashkuara, kur ata kanë marrë pjesë në kolegjin përkatës.

GJYKATA KUSHTETUESE

pasi shqyrtoi dokumentet dhe bisedoi çështjen në tërësi.

V Ë R E N:

Neni 145, pika 2 e Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, i njeh drejtën gjyqtarëve që në çdo fazë të gjykimit, kur ato çmojnë se ligjet vijnë në kundërshtim me Kushtetutën, të mos i zbatojnë ato, duke vendosur pezullimin e çështjes dhe dërgimin e saj Gjykatës Kushtetuese.

Përmbajtja e kësaj dispozite ka të bëjë me kontrollin kushtetues të ligjeve, të realizuar nga Gjykata Kushtetuese, por që për inicues ka gjykatat e sistemit të zakonshëm, të cilat pezullojnë gjykimin kur gjatë shqyrtimit të një çështjeje gjyqësore ende të pazgjidhur, përfundimi i së cilës varet nga ligji konkret, arrijnë në përfundimin se ligji nuk është i pajtueshëm me Kushtetutën. Ky lloj gjykimi kushtetues kërkon domosdoshmërisht ekzistencën e një lidhjeje të drejtpërdrejtë midis ligjit, antikushtetutshmëria e të cilit çmohet si e tillë nga gjykata dhe zgjidhjes së çështjes konkrete.

Në çështjen e paraqitur për shqyrtim në Gjykatën Kushtetuese, kërkuesi nuk e ka vlerësuar këtë kriter të rëndësishëm, pasi pezullimi i gjykimit të saj në seancë gjyqësore në Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë, duke arsyetuar se pjesë të veçanta të nenit 473 të Kodit të Procedurës Civile janë të papajtueshme me Kushtetutën, përbën një tejkalim të vetë kuptimit që duhet të ketë përmbajtja e nenit 145, pika 2 e Kushtetutës.

Rregullimet ligjore të parashikuara në nenin 473 të Kodit të Procedurës Civile, kanë të bëjnë me mënyrën e ushtrimit të rekursit në interes të ligjit ndaj vendimeve të formës së prerë si dhe me procedurën që ndiqet nga ana e gjyqtarëve të Gjykatës së Lartë në këtë fazë të shqyrtimit të çështjes. Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë që kanë shqyrtuar çështjen konkrete në seancë gjyqësore kanë vendosur gabimisht pezullimin e çështjes, në kuptim të nenit 145, pika 2 e Kushtetutës me idenë se neni 473 i Kodit të Procedurës Civile është çmuar nga ana e tyre si i papajtueshëm me Kushtetutën, për arsye se kjo dispozitë procedurale nuk është e zbatueshme gjatë procedurës së gjykimit në Kolegjet e Bashkuara, pasi i përket kolegjit seleksionues dhe një faze tashmë të përfunduar. Gjithashtu, për rastin konkret nuk rezulton që të ekzistojë ndonjë lidhje e drejtpërdrejtë e antikushtetutshmërisë së dispozitës konkrete të atakuar me mënyrën e zgjidhjes së çështjes me objekt pavlefshmërinë e dëshmisë së trashëgimisë nga ana e Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë.

Për Gjykatën Kushtetuese është i mjaftueshëm arsyetimi i mësipërm për të arritur në përfundimin se kërkesa e Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë, meqenëse nuk i përgjigjet kuptimit të nenit 145/2 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, është e pabazuar dhe për rrjedhojë duhet rrëzuar.

Megjithatë, duke u nisur nga fakti se kërkuesi me argumentet që ka parashtruar lidhur me papajtueshmërinë e nenit 473 të Kodit të Procedurës Civile me Kushtetutën, ka bërë një interpretim të gabuar jo vetëm të ligjit konkret, por edhe të vendimit nr.48, datë 30.07.1999 të gjykatës Kushtetuese, çmohet e domosdoshme që të arsyetohet edhe mbi pretendimet e tjera të tij.

Argumenti kryesor që përdor kërkuesi në këtë çështje, sipas të cilit kufizimet e parashikuara në nenin 473 të Kodit të Procedurës Civile lidhur me mospjesëmarrjen në kolegjin seleksionues të gjyqtarëve që kanë gjykuar më parë çështjen si dhe caktimi i relatorit me short nga gjyqtarët që nuk kanë marrë pjesë në gjykimin e çështjes, çënojnë nenin 42/1 të kushtetutës për procesin e rregullt ligjor, është i pabazuar dhe njëkohësisht dhe kontradiktor.

Neni 473 i Kodit të Procedurës civile është hartuar nga ligjvënësi në një mënyrë që t'i garantojë palëve në gjykim, një proces të rregullt ligjor. Fakti i mospjesëmarrjes në kolegjet

seleksionuese të gjyqtarëve që kanë gjykuar më parë çështjen, apo caktimi i relatorit nga ata gjyqtarë që nuk e kanë gjykuar më parë çështjen, janë elementë të rëndësishëm ligjor që i shërbejnë garantimit të zhvillimit normal të një gjykimi të rregullt dhe të paanshëm.

Pranimi i pretendimeve dhe i objektit të kërkesës që parashtron venimi i Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë për shfuqizimin e atyre kufizimeve që parashikon neni 473 i Kodit të Procedurës Civile, që në vetvete përmbajnë më shumë garanci për një gjykim të drejtë dhe të paanshëm, bie ndesh me argumentet e kërkesës dhe me vetë konceptin që ai ka kriuar për rregullsinë e procesit gjyqësor.

Gjithashtu, edhe referimi i kërkesës në vendimin nr.48, datë 30.07.1999 të Gjykatës Kushtetuese, jo vetëm është i pasaktë dhe i gabuar, por njëkohësisht interpretimi që Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë kanë marrë përsipër t'i bëjnë këtij vendimi përfundimtar dhe të detyrueshëm për të gjithë, për edhe një tejkalim në kompetencat e këtij organi gjyqësor.

Vendimi i sipërcituar i Gjykatës Kushtetuese nuk ka patur arsye dhe as qëllimin të bëjë referime në nenin 72 të Kodit të Procedurës Civile, por ka interpretuar dispozitat kushtetuese që lidhen me parimin e paanësisë në gjykim.

Mospjesëmarrja në shqyrtimin e ankimeve të vendimeve të gjyqtarëve të shkarkuar nga detyra në Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë e disa anëtarëve të kësaj gjykate, të cilët kanë marrë pjesë dhe kanë votuar më parë me cilësinë e anëtarit në mbledhjet e Këshillit të Lartë të Drejtësisë, është një çështje paanshmërie që nuk duhet konfunduar me rastet e papajtueshmërisë ndërmjet funksioneve.

Interpretimi që i është bërë dispozitave kushtetuese lidhur me parimin e paanësisë në gjykim nga Gjykata Kushtetuese dhe respektimi i këtij parimi, nuk duhet të keqkuptohet dhe as të bëhet shkak që çështjet, të cilat paraqiten për shqyrtim pranë Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë, të mbeten pa u gjykuar me arsyetimin, se shkelet parimi i paanësisë në gjykim dhe cënohet procesi ligjor. Parimi i paanësisë në gjykim është i detyrueshëm të respektohet dhe zbatohet nga çdo organ gjyqësor, por kjo nuk duhet të krijojë pamundësi në marrjen e vendimit dhe krizë institucionale për organin gjyqësor, siç janë Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë, i cili është i vetëm në ushtrimin e kësaj kompetence dhe që detyrë primare ka përmbushjen e funksionit të tij kushtetutes.

Për sa më sipër, Gjykata Kushtetuese arrin në përfundimin se kërkesa e paraqitur nga Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë është e pabazuar dhe për rrjedhojë nuk duhet pranuar.

PËR KËTO ARSYE:

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, duke u bazuar në nenet 131,132 dhe 145 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë si dhe në nenet 72 e 86 të Ligjit nr.8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, njëzëri,

V E N D O S I

Rrëzimin e kërkesës.

Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Tiranë, më 07.04.2000
Nr.10 i Regj.Themeltar
Nr.15 i Vendimit

VENDIM NË EMËR TË REPUBLIKËS

Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë të përbërë nga:

Thimjo Kondi Kryesues

Bashkim Caka	Anëtar
Natasha Sheshi	“
Metush Saraçi	“
Vitore Tusha	“
Tefta Zaka	“
Vangjel Kosta	“
Artan Hoxha	“
Vladimir Metani	“
Agron Lamaj	“
Nikoleta Kita	“
Valentina Kondili	“
Vladimir Bineri	“
Zamir Poda	“
Ylvi Myrtja	“

në seancën gjyqësore të datës 15.5.2000 morën në shqyrtim çështjen civile që u përket:

PADITËS: Liljana Buleci, në mungesë
TË PADITUR: Vasilaq Buleci, përfaqësuar nga Av.Dashamir Kore
Valentina Buleci, në mungesë.

OBJEKTI: Pjesëtim pasurie, marrjen e masës së sigurimit duke pezulluar punimet që i padituri bën në oborrin e shtëpisë. Neni 200 e vijues i Kodit Civil dhe 153, 202 e 369/a të K.Pr.Civile.

Gjykata e rrethit gjyqësor Korçë, me vendimin nr.1856, datë 11.12.1998, në fazën e dytë të pjestimit ka vendosur:

Shtëpia dykatëshe i lihet të paditurit Vasillaq duke u detyruar t'i paguajë paditëses Liljana 212 844 lekë; dyqani Nr.1 i lihet të paditurit Vasillaq dhe dyqani Nr.2 i lihet në bashkëpronësi paditëses Liljana e të paditurës Valentina. Detyrohen Liljana e Valentina të kompensojnë Vasillaqin nga 8 139 lekë secila për dyqanet; pushim gjykimi për truallin.

Gjykata e Apelit Korçë, me vendimin nr.210, datë 7.7.1999 ka vendosur:

Ndryshimin e vendimit të mësipërm, të paditurit Vasillaq i lihet shtëpia dykatëshe, paditëses Liljana dyqani Nr.1, të paditurës Valentina dyqani Nr.2 dhe për kompensim Vasillaqi t'i paguajë Liljanës shumën prej 375 000 lekë dhe Valentina t'i paguajë Vasillaqit shumën prej 375 000 lekë.

Kundër vendimit të gjykatës së Apelit Korçë, ka ushtruar rekurs pala e paditur Vasillaq Buleci duke kërkuar: prishjen e dy vendimeve dhe kthimin e çështjes për rigjykim duke parashtruar këto shkaqe:

- Vendimi i fazës së parë që ka caktuar pjesët nuk është i drejtë dhe meqenëse ai është kundërshtuar bashkë me vendimin përfundimtar, në bazë të nenit 470 të K.Pr.Civile, gjykata e Apelit duhet ta ndryshonte bashkë me vendimin përfundimtar

- Gjykata e Apelit në bazë të nenit 81 të K.Pr.Civile cakton një vlerë shumë më të madhe të shtëpisë nga ajo që ka caktuar eksperti duke e rritur atë në 3 000 000 lekë dhe këtë e ka bërë pa arsyetuar shkakun, ç'ka e bën vendimin të pabazuar sipas dispozitës së mësipërme të K.Pr.Civile.

- Nëse do të prishet vendimi i fazës së parë si i padrejtë, atëherë mua si i paditur pjesa më e rritur në 6/8 pjesë dhe në këtë mënyrë nuk do të kishte arsye që paditëses t'i lihej një dyqan po ajo thjesht mund të kompensohej.

Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, me vendimin datë 21.3.2000 ka vendosur dërgimin e çështjes për shqyrtim në Kolegjet e Bashkuara për unifikimin e praktikës gjyqësore lidhur me problemet e mëposhtme:

1. Në çështjet me objekt pjestim pasurie, gjykata që shqyrton, respektivisht, apelin apo rekursin kundër vendimit të fazës së dytë të pjestimit a ka të drejtë t'i hyjë shqyrtimit të kërkesave për pabazueshmërinë e vendimit të fazës së parë të pjestimit?

2. Mosrespektimi i kërkesave të nenit 373/1 të K.Pr.Civile, (“...gjykata harton një projekt-

pjesëtimi të cilin e depoziton në sekretari jo më pak se dhjetë ditë përpara seancës së ardhshme gjyqësore. Palët kanë të drejtë të parashtrojnë vërejtjet e tyre për projektin e depozituar, jo më vonë se pesë ditë përpara seancës së ardhshme gjyqësore”) a përbën shkelje të rëndë procedurale dhe cënim të parimit kushtetues të një procesi të rregullt ligjor?

KOLEGJET E BASHKUARA TË GJYKATËS SË LARTË

Pasi dëgjuan relatimin e kryesuesit Thimjo KONDI,
Përfaqësuesin e palës së paditur Av.Dashamir Kore që kërkoi prishjen e vendimit të gjykatës së Apelit Korçë për shkaqet e parashtuara në rekurs, e pasi bisedoi çështjen në tërësi,

VËREJNË:

Vendimi nr.210, datë 7.7.1999 i gjykatës së Apelit Korçë për fazën e dytë të pjestimit të pasurisë ndërmjet palëve ndërgjyqësore është i pabazuar dhe duhet të priset për zbatim të gabuar të ligjit, (neni 472, pika "a" i K.Pr.Civile).

Nga materialet e çështjes rezulton se: Gjykata e shkallës së parë Korçë, mbështetur në shpjegimet e konkluzionet e ekspertit Pandi Treska, e ka llogaritur vlerën e shtëpisë bashkë me truallin në shumën 851 375 lekë. Gjykata e Apelit Korçë ka urdhëruar ekspertim të ri dhe ekspertët A.Rapi e S.Ktona e kanë vlerësuar shtëpinë së bashku me truallin e saj me shumën 1 566 lekë. Kjo gjykatë ka konkluduar se vlerësimi që kanë bërë ekspertët e caktuar prej saj nuk është i saktë e real, prandaj nuk e ka pranuar atë dhe përfundimisht e ka vlerësuar vetë shtëpinë së bashku me truallin në shumën 3 000 000 lekë. Në caktimin e vlerës së mësipërme gjykata arsyeton se vlera e truallit në atë zonë është 100 USD për m², se një apartament banimi 2+1 në pallat shitet nga 2-3 milionë lekë dhe se kontratat noteriale të shitjes së shtëpive me kushte afërsisht të barabarta përmbajnë çmime më të ulta nga vlera reale e tyre me qëllim që t'u shmangen taksave, etj. Pohime e konkluzione për fakte e rrethana si ato që përshkruhen më lart nuk mund të vihen në themel të një vendimi gjyqësor, për shkaqe që do t'i parashtrojmë më poshtë. Megjithatë, edhe sikur për një moment t'i pranojmë ato të mirëqena, përsëri gjykata nuk shpjegon pse vlera e shtëpisë e caktuar prej saj është pikërisht tre milion lekë dhe as më shumë apo as më pak. Për rrjedhojë, edhe thjesht në këtë këndvështrim të gjërave vendimi i saj nuk është i bazuar.

Faktet e rrethanat e përmendura në vendimin e apelit për të justifikuar caktimin e vlerës së shtëpisë nuk kanë vlerën e provës sepse, lidhur me to, gjykata ka shkelur rëndë një sërë dispozitash procedurale që garantojnë një proces të drejtë e të rregullt. Sipas nenit 10 të K.Pr.Civile, "gjykata e mbështet vendimin e saj vetëm mbi faktet që janë paraqitur gjatë procesit gjyqësor", ndërsa sipas nenit 11 të K.Pr.Civile, "provat janë të dhëna që merren në formën e parashikuar nga ky kod dhe që vërtetojnë ose rrëzojnë pretendimet ose prapësimet e pjesëmarrësve në proces".

Ndonëse gjykata, siç ishte e detyruar, nuk ka marrë një vendim konform nenit 465 të K.Pr.Civile, për të përcaktuar në se do të mjaftojë me leximin e akteve të gjykimit të shkallës së parë, apo do të merrte edhe prova të reja, duke përsëritur tërësisht apo pjesërisht hetimin gjyqësor, nga kqyrja e proces-verbalit në fakt rezulton se gjykata e Apelit ka përsëritur pjesërisht hetimin gjyqësor. Ajo ka urdhëruar vetëm kryerjen e një ekspertimi të ri teknik, pra nuk ka kërkuar dhe nuk ka administruar prova të tjera. Nga sa më lart në mënyrë të natyrshme e logjike shtrohet pyetja: Me cilat prova e ka rrëzuar gjykata e Apelit konkluzionin e ekspertëve për vlerën e shtëpisë? Është e vërtetë që, sipas nenit 81/2 të K.Pr.Civile të cilit i referohet edhe gjykata e Apelit, "mendimi i ekspertit nuk është i detyrueshëm për gjykatën dhe kur kjo ka mendim të kundërt me ekspertin, duhet të arsyetojë me hollësi këtë mendim në vendimin përfundimtar ose në një vendim që jep gjatë gjykimit". Është e vërtetë gjithashtu që gjykata e Apelit në vendimin përfundimtar është përpjekur të japë argumenta për të rrëzuar konkluzionin e ekspertëve, por argumentat e saj nuk janë nxjerrë nga prova, të cilat ajo i ka lejuar, administruar e vlerësuar si të tilla, konform dispozitave përkatëse të K.Pr.Civile. Çdo përfundim, qoftë edhe rezultat i një analize të hollësishme, jashtë provave të çështjes nuk ka asnjë vlerë për të. Në çështjen në shqyrtim gjykata e Apelit, duke mos krijuar bindje prej konkluzioneve të dy ekspertimeve, ishte e detyruar, ose të merrte prova të tjera të kërkuara nga palët, analiza e të cilave do të çonte në një përfundim tjetër, ose të urdhëronte përsëritjen e ekspertimit, sipas kërkesave të nenit 229 të K.Pr.Civile.

Gjykata e Apelit, në seancën e datës 13.5.1999 ka vendosur "t'u vërë detyrë ekspertëve për të zgjeruar hetimet lidhur me caktimin e vlerës reale të shtëpisë...". Ajo ka kërkuar nga ekspertët të marrin kontrata në zyrat noteriale, si dhe kontrata të sjella nga palët, për shitje shtëpish me të njëjtat kushte. Ky qëndrim i gjykatës është i gabuar, sepse ajo ngatërron rolin e saj me atë të ekspertëve. Sipas nenit 80 të K.Pr.Civile, ekspertët thirren nga gjykata jo për të zëvendësuar atë në kryerjen e detyrave të saj, por vetëm "kur për konstatimin ose sqarimin e fakteve, që kanë lidhje me mosmarrëveshjen në gjykim, kërkohen njohuri të posaçme në fushat e shkencës, teknikës ose të artit...". Caktimi i detyrave për ekspertët, sipas nenit 227 të K.Pr.Civile nuk mund të tejkalojë qëllimin e caktuar në nenin 80 të këtij kodi, të cituar më lart. Marrja me cilësinë e provave shkencore, e kontratave të shitjes së shtëpive nga zyrat noteriale dhe e çdo dokumenti tjetër të nevojshëm, të kërkuar nga palët, me qëllim të përcaktimit të kërkesë-ofertës për shitblerje, është detyrë e gjykatës dhe jo e ekspertëve.

Në rekursin e paraqitur nga pala e paditur pretendohet se, në çështjet me objekt pjesëtim pasurie, gjykata që shqyrton apelin apo rekursin kundër vendimit të fazës së dytë të pjestimit (gjykata e Apelit apo Gjykata e Lartë, respektivisht), ka të drejtë t'i hyjë shqyrtimit jo vetëm të bazueshmërisë së vendimit të fazës së dytë të pjestimit, por edhe të vendimit të fazës së parë.

Praktika gjyqësore shumëvjeçare ka qenë unike në këtë drejtim, duke mbajtur qëndrim të ndryshëm nga ai që pretendohet në rekurs, d.m.th gjykata që shqyrton bazueshmërinë e vendimit të fazës së dytë nuk ka të drejtë të marrë në shqyrtim probleme që kanë të bëjnë me fazën e parë të gjykimit dhe që, si të tilla, janë zgjidhur me vendimin e kësaj faze. Megjithatë, konstatohet se kohët e fundit Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë në ndonjë rast ka mbajtur qëndrim disi të ndryshëm. Kështu p.sh, Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë në çështjen e S.Sh kundër T.Sh, me vendimin nr.409, datë 21.3.2000, mbasi ka shqyrtuar rekursin kundër vendimeve të fazës së dytë të pjestimit, ka vendosur prishjen e vendimit nr.14, datë 5.2.1999 të gjykatës së Apelit Korçë e të vendimit nr.158, datë 4.2.1998 të gjykatës së shkallës së parë Korçë dhe pushimin e gjykimit të çështjes. Kolegji Civil arsyeton se, me prishjen e dy vendimeve të mëparshme të fazës së dytë të pjestimit dhe pushimin e gjykimit të çështjes (duke shuar kështu edhe efektet e vendimit të fazës së parë të pjestimit për këtë çështje), bëhet e mundur që palët të realizojnë të drejtat e tyre sipas kërkesave ligjore, të shkelura gjatë gjykimit të fazës së parë të pjestimit. Në pjesën arsyetuese të këtij vendimi përmenden konkretisht shkeljet ligjore të lejuara në gjykimin e fazës së parë.

Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë janë të mendimit se, në asnjë rast e për çfarëdo lloji shkak, gjykata që shqyrton bazueshmërinë e vendimit të fazës së dytë të pjestimit të pasurisë nuk ka të drejtë të shqyrtojë probleme që lidhen me gjykimin e fazës së parë.

Pretendimi i ngritur në rekurs, sipas të cilit vendimi i fazës së parë të pjestimit mund të kundërshtohet bashkë me vendimin përfundimtar, (që është vendimi i fazës së dytë të pjestimit) në bazë të nenit 470 të K.Pr.Civile, është i gabuar. Kjo dispozitë, në paragrafin e parë të saj, parashikon se "vendimet e ndërmjetme që jepen nga gjykata e shkallës së parë...mund të goditen me ankim së bashku me vendimin përfundimtar". Ky është rregulli i përgjithshëm, por në paragrafin e dytë të kësaj dispozite, të cilin nuk e ka parasysh ankuesi ose që e anashkalon, parashikohet se, "Megjithatë, në rastet e parashikuara shprehimisht në këtë Kod, kundër vendimeve të ndërmjetme mund të bëhet ankim i veçantë në gjykatën e Apelit, brenda pesë ditëve nga shpallja apo njoftimi i tyre". Pikërisht, vendimi i fazës së parë të pjestimit, i parashikuar shprehimisht në nenet 370 e 371 të K.Pr.Civile dhe i emërtuar si vendim i ndërmjetëm, është një vendim kundër të cilit lejohet ankim i veçantë, paraqitja e të cilit pezullon vazhdimin e mëtejshëm të gjykimit. Duhet të sqarojmë se ky vendim është një vendim i ndërmjetëm i një lloji të veçantë (sui generis). Vendimi i fazës së parë të pjestimit të pasurisë nuk është i njëjtë për të gjithë efektet me vendimet e tjera të ndërmjetme që jepen gjatë gjykimit të një çështjeje, sipas përcaktimeve që bëhen në nenet 125 dhe 315 të K.Pr.Civile. Sipas nenit 125 të K.Pr.Civile, "Vendimet e ndërmjetme jepen nga gjykata në seancën gjyqësore, me qëllim që të sigurohet zhvillimi i gjykimit në pajtim me dispozitat e këtij Kodi", ndërsa sipas nenit 315 të K.Pr.Civile, që mban titullin "vendimet e ndërmjetme", "Vendimet që jepen gjatë gjykimit dhe që nuk janë përfundimtare, mund të ndryshohen ose të revokohen nga gjykata që i ka dhënë, përveç kur në këtë kod parashikohet se kundër tyre mund të bëhet ankim i veçantë". Nga interpretimi në këtë kod parashikohet se kundër tyre mund të bëhet ankim i veçantë". Nga interpretimi në tërësi i dispozitave të sipërcituara arrijmë në përfundimin se vendimet e ndërmjetme si rregull janë të karakterit procedural, jepen gjatë gjykimit të çështjes, nuk janë përfundimtare, dhe si rregull nuk kanë bëjnë me zgjidhjen e

çështjes në themel.

Në dallim nga karakteristikat e mësipërme, vendimet e fazës së parë të pjestimit, të cilat i kemi cilësuar më lart si vendime të ndërmjetme të një lloji të veçantë (sui generis), nuk janë vendime të karakterit thjesht procedural, d.m.th nuk jepen vetëm për të siguruar normalitetin e zhvillimit të gjykimit brenda kërkesave të normave procedurale. Nisur nga karakteri i posaçëm i gjykimit të çështjeve me objekt pjesëtim pasurie dhe i ndarjes së tij në dy faza të veçanta, ligjvënësi e ka çmuar të nevojshme dhe të dobishme që disa probleme t'i zgjidhë në themel dhe në mënyrë përfundimtare me vendim të ndërmjetëm në mbyllje të fazës së parë. Sipas nenit 370 të K.Pr.Civile, me vendimin e fazës së parë të pjestimit përcaktohet se cilat sende (pasuri) do t'i nënshtrohen pjestimit, kush janë bashkëpronarët (apo bashkëtrashëgimtarët) dhe cilat janë pjesët takuese (ideale) të tyre në bashkëpronësi.

Duke pasur parasysh kërkesat e nenit 451 dhe në tërësi, dispozitat e K.Pr.Civile konkludojmë se vendimi i fazës së parë të pjestimit të pasurisë merr formë të prerë kur: 1. *Palët deklarojnë se nuk kanë ankim duke u pasqyruar ky deklaram në formën e posaçme të parashikuar në fjalinë e parë të nenit 371 të K.Pr.Civile;* 2. *Ka kaluar afati 5 ditor i ankimit;* 3. *Ankimi është paraqitur, është shqyrtuar nga gjykata e Apelit dhe vendimi është lënë në fuqi, ndryshuar ose është pushuar gjykimi në shkallë të dytë;* 4. *Kundër vendimit të gjykatës së Apelit është ushtruar rekurs në Gjykatën e Lartë dhe vendimi është lënë në fuqi.*

Gjersa në rastet e mësipërme vendimi i fazës së parë merr formë të prerë, problemet e zgjidhura me të përbëjnë gjë të gjykuar dhe, për rrjedhojë, ato nuk mund t'i nënshtrohen një shqyrtimi të ri në fazën e dytë të pjestimit në cilëndo shkallë të gjykimit (shkallë e parë, Apel apo gjykatë e Lartë) që të ketë kaluar çështja. Bazueshmëria e një vendimi të formës së prerë nuk mund të kontestohet, veçse kur në Kodin e Procedurës Civile parashikohen shprehimisht forma dhe mjete të posaçme për një gjë të tillë. Kundërshtimi i vendimit të fazës së parë të pjestimit të pasurisë së bashku me vendimin e fazës së dytë nuk parashikohet në ndonjë dispozitë të Kodit të Pr.Civile, as në mënyrë të shprehur, as të nënkuptuar.

Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë gjithashtu vërejnë se, si në çështjen objekt shqyrtimi, edhe në çështje të tjera të gjykuara më parë, në fazën e dytë të pjestimit të pasurisë gjykatat nuk zbatojnë kërkesat e nenit 373/1 të K.Pr.Civile, sipas të cilit "Kur sendi ndahet në natyrë dhe pjesët e formuara janë të barabarta ose barazohen me para, gjykata harton një projekt-pjestimi të cilin e depoziton në sekretari jo më pak se dhjetë ditë përpara seancës së ardhshme gjyqësore. Palët kanë të drejtë të parashtrajnë vërejtjet e tyre për projektin e depozituar, jo më vonë se pesë ditë përpara seancës së ardhshme gjyqësore".

Hartimi i projekt-pjestimit dhe paraqitja e tij përpara palëve është një detyrim për gjykatën që shqyrton çështjen, ndërsa parashtrimi i vërejtjeve për projektin nga palët është një e drejtë e tyre që mund të ushtrohet në se çmohet e nevojshme. Mosparaqitja e projekt-pjestimit u heq mundësinë palëve për të ushtruar një të drejtë të çështjes, pasi palët mund të sugjerojnë zgjidhje të tjera më të përshtatshme, që mund të plotësojnë më mirë kërkesat dhe interesat e tyre të ligjshme e që mund të çonin edhe në zgjidhjen e çështjes me mirëkuptim. Kryerja e veprimeve të parashikuara në nenin 373/1 të K.Pr.Civile, brenda afateve përkatëse, përbën edhe një rregullim të caktuar procedural të domosdoshëm që diktohet nga natyra e posaçme e gjykimit të çështjeve për pjesëtim pasurie.

Të gjitha sa parashtrohen më lart të çojnë në përfundim që mosrespektimi i kërkesave të nenit 373/1 të K.Pr.Civile përbën shkelje të rëndë të rregullave procedurale që kjo shkelje sjell në mënyrë të domosdoshme prishjen e vendimit të kundërshtuar.

PËR KËTO ARSYE

Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë, në bazë të nenit 485, pika "c", të K.Pr.Civile,

V E N D O S Ë N

1. Prishjen e vendimit nr.210, datë 7.7.1999 të gjykatës së Apelit Korçë dhe dërgimin e çështjes për rishqyrtim në atë gjykatë, me tjetër trup gjykues.
2. Ky vendim për njësimin e praktikës gjyqësore të dërgohet për botim në Fletoren Zyrtare.

Tiranë, më 15.5.2000

Nr.1937/642 i Regj. Themeltar
Nr.628 i Vendimit

ANËTAR Bashkim Caka	ANËTAR N.Sheshi	KRYESUES Th.Kondi
ANËTAR M.Saraçi	ANËTAR V.Tusha	ANËTAR V.Kosta
ANËTAR A.Lamaj	ANËTAR V.Bineri	ANËTAR T.Zaka
ANËTAR N.Kita	ANËTAR Z.Poda	ANËTAR V.Kondili
ANËTAR Y.Myrtja	ANËTAR V.Metani	NËTAR A.Hoxha

Arsyetim paralel

Jam i të njëjtit mendim me shumicën lidhur me mënyrën e zgjidhjes së çështjes. Kam mendim të ndryshëm përsa i përket rasteve se kur mund të shqyrtohen vendimet e fazës së parë të pjestimit dhe cila gjykatë.

Sipas dispozitave të Kodit të Procedurës Civile llojet e vendimeve që jep gjykata ndahen në vendime të ndërmjetme, që jepen nga gjykata në seancë gjyqësore, me qëllim që të sigurohet zhvillimi i gjykimit në pajtim me dispozitat e këtij kodi (neni 125), vendime përfundimtare, që jepen nga gjykata në përfundim të gjykimit të cilët e zgjidhin në mënyrë përfundimtare çështjen (neni 126) dhe në vendime jopërfundimtare, që i japin fund procesit gjyqësor civil pa e zgjidhur çështjen në themel (neni 127). Gjykimi për pjestimin e sendeve në bashkëpronësi dhe në trashëgim sipas legjislacionit procedural ndahet në dy faza. Në fazën e parë të pjestimit, gjykata, siç përcakton neni 370 i K.Pr.Civile, me vendim që jepen nga gjykata e shkallës së parë mund të ndryshohen apo tërhiqen gjatë gjykimit përveç kur në kod është parashikuar se ndaj tyre mund të bëhet ankim i veçantë (neni 315). Këtë qëllim ka edhe paragrafi i dytë i nenit 470 të K.Pr.Civile që parashikon se "në rastet e parashikuara shprehimisht në këtë kod, kundër vendimeve të ndërmjetme mund të bëhet ankim i veçantë në gjykatën e Apelit, brenda 5 ditëve nga shpallja apo njoftimi i tyre". Në rast se ndaj vendimit të fazës së parë të pjestimit si "vendim i ndërmjetëm" ushtrohet "ankim i veçantë" në përputhje me dispozitat e mësipërme dhe çështja shqyrtohet nga gjykata e apelit apo dhe me rekurs në Gjykatën e Lartë, vendimi i fazës së parë merr formë të prerë dhe problemet e zgjidhura me të përbëjnë gjë të gjykuar dhe prandaj ato nuk mund t'i nënshtrohen një shqyrtimi të ri në fazën e dytë të pjestimit në cilëndo shkallë të gjykimit. Përkundrazi, në rast se vendimi i fazës së parë të pjestimit ka marrë formë të prerë sipas përcaktimeve të bëra në nenin 371 të K.Pr.Civile (palët deklarojnë se nuk kanë ankim kundër vendimit të ndërmjetëm ose kur vendimi i ndërmjetëm që ka lejuar pjesëtimin ka marrë formë të prerë), nuk mund të mohohet e drejta e palëve që këto vendime të goditen së bashku me vendimin përfundimtar, që në këtë rast është vendimi i fazës së dytë të pjestimit. Për rrjedhojë vendimi i fazës së parë të pjestimit, në kushtet e mësipërme, mund të goditet në gjykatën e Apelit dhe në gjykatën e Lartë së bashku me vendimin përfundimtar, ndërsa në gjykatën e shkallës së parë i formon gjë të gjykuar.

Është e vërtetë se praktika shumëvjeçare ka mbajtur qëndrimin se vendimi i fazës së parë të pjestimit, mbasi ka marrë formë të prerë nuk mund të merret në shqyrtim nga gjykata e shkallës së dytë, kur çështja gjykohej nga kjo gjykatë me rastin e shqyrtimit të ankimit kundër vendimit

përfundimtar të fazës së dytë. Por në legjislacionin e mëparshëm gjendeshin mundësi ndërhyrjeje ligjore kur në gjykimin e ankimit të vendimit të fazës së dytë të pjestimit, konstatoheshin paligjshmëri të lejuara në fazën e parë të pjestimit të të ankimuar nga pala e interesuar. Përveç kësaj neni 336 i Kodit të Procedurës Civile të vitit 1958 dhe neni 152 të K.Pr.Civile të vitit 1982 nuk e konsideronte në mënyrë të shprehur këtë vendim si "të ndërmjetëm" megjithëse parashikonte ankimin e veçantë kundër tij. Specifikimi që kodi i ri i procedurës civile u bën këtyre vendimeve si "të ndërmjetëm" tregon për një mënyrë të ndryshme trajtimi nga eksperiencia e mëparshme. Në ligj, teori dhe në praktikën e mëparshme është pranuar se kur prokurori nuk merr pjesë në gjykimin e fazës së parë, për rrjedhim as edhe në dhënien e vendimit të fazës së parë, ka të drejtë ta protestojë këtë vendim së bashku me vendimin përfundimtar, neni 152/2 të K.Pr.Civile, të vitit 1982. Me të vërtetë ligjvënësi e ka parë të nevojshme që disa probleme t'i zgjidhë në mënyrë përfundimtare me vendim të ndërmjetëm në mbyllje të fazës së parë. Por duke u përcaktuar se gjykimi në fazën e dytë vazhdon kur vendimi i ndërmjetëm që ka lejuar pjesëtimin e pasurisë ka marrë formë të prerë, ligji nuk ka patur parasysh që këtë vendim ta barazojë me të gjitha efektet me formën e prerë të vendimeve përfundimtare. Mendoj se "sui generis" është forma e prerë që merr vendimi i fazës së parë të pjestimit. Është e vërtetë se kundërshtimi i vendimit të fazës së parë të pjestimit së bashku me vendimin e fazës së dytë nuk parashikohet në ndonjë dispozitë të K.Pr.Civile as në mënyrë të shprehur e as të nënkuptuar, por kjo nuk do të thotë se nuk është e lejuar një gjë e tillë. Pjesëtimi gjyqësor në analizë të fundit është objekti i kërimit në padinë e ngritur në gjykatë dhe ndarja në faza gjykimi, nuk do të thotë se çdo fazë në mënyrë të shkëputur mund të trajtohet si çështje civile e veçantë. Për rrjedhojë ai mund të goditet si vendim i ndërmjetëm në kushtet që shpjegojmë më lart. Ligji (neni 371 i K.Pr.Civile) vetëm përcakton se gjykata vazhdon gjykimin në fazën e dytë; a) kur palët deklarojnë se nuk kanë ankim ndaj vendimit të ndërmjetëm dhe b) kur vendimi i ndërmjetëm që ka lejuar pjesëtimin ka marrë formë të prerë. Pra parashikohet mundësia e vazhdimin të gjykimit dhe nuk rezulton që ligjvënësi ta ketë bazuar përfundimin e fazës së parë të pjestimit me vendimet përfundimtare të formës së prerë.

Është e lidhur me arsyetimin e mësipërm edhe rasti kur paditësi në fazën e gjykimit heq dorë nga gjykimi i padisë. Në këtë rast në bazë të nenit 299 të K.Pr.Civile gjykata vendos pushimin e gjykimit nuk i shuan efektet e pjestimit të fazës së parë. Kjo zgjidhje nuk përputhet me përmbajtjen e nenit 300 të K.Pr.Civile, ku është parashikuar se pushimi i gjykimit sjell si pasojë anulimin e të gjitha veprimeve procedurale, duke përfshirë edhe vendimet që jepen gjatë gjykimit. Në këtë logjikë vendimi i fazës së parë të vendimit megjithëse sipas nenit 370 të K.Pr.Civile zgjidh me vendim të ndërmjetëm në mënyrë përfundimtare se cilat sende do t'i nënshtrohen pjestimit, kush janë bashkëpronarët, dhe se cilat janë pjesët takuese të tyre në bashkëpronësi, nuk mund të konsiderohet si vendimet e tjera të formës së prerë, për t'u kontestuar vetëm kur parashikohet në mënyrë të shprehur në kodin e procedurës civile. Është e vërtetë se në raste të veçanta, paditësi mund të abuzojë me heqjen dorë nga gjykimi i padisë, meqenëse pushimi i gjykimit nuk e shuan padinë, por kjo kufizohet nga e drejta që ka çdo bashkëpronar që në çdo moment të kërkojë në rrugë gjyqësore pjesëtimin e sendit të përbashkët apo shpërblimin për përdorimin e pjesëve të tyre.

Si konkluzion të argumenteve të mësipërme mund të themi se vendimi i fazës së parë të pjestimit gjyqësor, megjithëse ka karakteristikat e vendimit përfundimtar, nuk është plotësisht i tillë. Në rast se kundër tij nuk është paraqitur ankim i veçantë, ai mund të goditet së bashku me vendimin përfundimtar.

Bashkim Caka

NDREQJE GABIMI

Në Fletoren Zyrtare nr.10, Prill 2000, ligji nr.8605, datë 20.4.2000, "Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr.8093, datë 21.3.1996 "Për rezervat ujore" faqe 445, në nenin 1, rreshti i pestë, pika a:

është "gjobë deri në 500 lekë", të bëhet "gjobë deri në 500 000 lekë".

U dorëzua për shtyp më 27.6.2000
Doli nga shtypi më 29.6.2000

Tirazhi: 3700 copë	Formati: 60x88/8
--------------------	------------------

Shtypshkronja "Tipografia Ushtarake"

Çmimi: 100 lekë